



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

Instituti për Planifikim Hapësinor - Institute for Spatial Planning - Institut za Prostorno Planiranje

DATË/A:	10.08.2012
REFERENC-Ë:	/AMMK/2011
PËR/ZA/TO:	Dr.sc Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Luan Nushi, Drejtor në IPH
NGA/OD/FROM:	Nexhmije Kamberi, Hulumtuese Profesioniste Besim Gollopi, Sociolog Planer
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport nga pjesëmarrja në trajnimin ndërkombëtar

I nderuar z. Kryeshef

Gjeni të bashkëngjitur raportin nga pjesëmarrja jonë në trajnimin ndërkombëtar në Izrael lidhur me: "Politikat, strategjitë dhe sistemi mbështetës për rivitalizimit rural". Në raport janë përshkruar disa nga leksionet e marra gjatë kohës së trajnimit dhe gjatë vizitave që janë bërë në teren.

Me respekt,



RAPORT

TRAJNIMI NDËRKOMBËTAR

01 – 26.07.2012

IZRAEL



Raport

Trajnimi ndërkombëtar: **“Politikat, strategjitë dhe sistemi mbështetës për rivitalizimin rural”**

01-26.07.2012

Rehovot, Izrael

Organizator: MASHAV-i dhe Qendra e Weitz-it

Pjesëmarrës: Kandidatët nga: Armenia, Bellorusia, Costa Rica, El Salvadori, Kosova, Kameruni, Kolumbia, Kenia, Kongo, Mali i Zi, Nigeria, Ruanda, Sërbia, Taxhikistani, Tanzania, Uganda dhe Uzbekistani

Vendi: Rehovot – Izrael

Data: 01-26.2012



Hyrje

Kryeqytet - Jerusalemi

Sipërfaqja - 22,072 km²

Popullësia - 7,890,60090 - arab 1,625,200 - hebrenj 5.938.000

Valuta - Shekel

Izraeli kufizohet me Libanin, Sirinë, Jordaninë dhe Egjiptin dhe ka standardin më të larta të jetës në Lindjen e Mesme. Pas pavarësisë së vitit 1948-të, shteti i ri hebrenjë u emërua zyrtarisht me emrin Medinat Partia ose shteti Izraelit, kurse emrat tjerë historik dhe fetar të propozuar përfshirë Eretz Izrael apo "Toka e Izraelit", Sioni dhe Judesë, u refuzuan, i gjithë rajoni ishte i njohur me emra të ndryshëm, kështuqë në javët e para të pavarësisë qeveria zgjodhi termin "izraelit" për të treguar një shtet Izraelit.



Qendra e Weitz-it për studime zhvillimore

Kjo qendër gjendet në mes Rehovotit, Tel avivit dhe Jerusalemit, është themeluar në vitin 1963 dhe udhëheq ngritjen e kapaciteteve për zhvillim të qëndrueshëm në aspektin global, me qëllim që të ofroj cilësi të lartë në zhvillimin e kapaciteteve dhe aktiviteteve mbështetëse rajonale dhe lokale, për formulimin strategjik të integruar të planifikimit të projektit. Zhvillimi i qendrës Weitz është i integruar dhe përfshinë punën në fusha multidisiplinare.



Fushat e specializimit:

- Zhvillimin e integruar rajonal dhe lokal
- Zhvillimin ekonomik të komunitetit
- Zhvillimin e qëndrueshëm
- Qeverisjen lokale dhe planifikimin strategjik komunal
- Përmirësimin e zonave të varfëra urbane dhe revitalizatin urban
- Menagjimin e ujërave të zeza dhe energjisë
- Planifikimin e mikro-rajoneve
- Konkurrencën rajonale dhe lokale
- Zbutjen e varfërisë
- Planifikimin bujqësor
- Industrializimin rural
- Aspektet sociale të planifikimit dhe zhvillimit
- Vlerësimin dhe formulimin e projektit
- Sistemin mbështetës për zhvillimin ekonomik dhe promovimin e ndërmarrësis
- Modelet e vendbanimeve rurale
- Planifikimin e zonave të reja të vendbanimit
- Ofrimin e sistemeve të shërbimit
- Turizmin rural

Programi i trajnimit:

Seanca hyrëse

Këshillat rajonale platforma për zhvillim strategjik

Qasja e Rehovotit për zhvillimin rural

Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm në bujqësi

Përvoja izraelite për zhvillimin dhe revitalizimin rural

Zhvillim rural dhe bujqësor në Izrael dhe sfidat në ruajtjen e natyrës

Sistemi i nevojshëm për mbështetjen e bujqësisë

Komuniteti kibuc dhe zhvillimi i qëndrueshëm



Platformat rajonale për zhvillim strategjik

Qendra për Bashkëpunim Ndërkombëtar për zhvillim bujqësor në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – CINADCO - funksionon si degë profesionale e Agjencisë së Izraelit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar - MASHAV, për zbatimin e politikave të Izraelit dhe bashkëpunim me vendet në zhvillim në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Për më tepër se 50 vite Izraeli ka ndarë përvojën e tij të zhvillimit në më shumë se 140 vende në zhvillim, bazuar në qasjen që përmirësimi i jetesë së njerëzve është qështje kryesore për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Aktivitetet profesionale duhet të përqëndrohen kryesisht në transferimin e njeriut, ndërtimin e kapaciteteve, njohurive profesionale dhe mbështetjen e projekteve për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor. Programet e bashkëpunimit të CINADCO-së përfshijnë aktivitete trajnuese dhe projektet e bashkëpunimit të kryera në Izrael dhe jashtë vendit, në disa gjuhë. Programet e mbulojnë një gamë të gjerë temash të lidhura me burimet e ujit, menaxhimin e ujit, bujqësisë së qëndrueshme dhe të orientuar drejt tregut, blegtorisë intensive dhe prodhimit të qumështit, kërkimet bujqësore dhe strukturave për zhvillim. Duke e njohur kompleksitetin e sfidave të zhvillimit në botën e sotme, qasje e Rehovotit bazohet në një model të planifikimit ndërdisiplinor dhe orientimit praktik, si:

- Planifikimi kombëtar
- Planifikimi lokal
- Planifikimi rajonal

Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm në bujqësi

Në planetin tonë jetojnë shtatë miliardë njerëz krahasuar me 3 miliardë që ka jetuar në vitin 1960. Popullsia është parashikuar të rritet mbi 10 miliardë banorë, në vitin 2050. Si rezultat i rritjes së popullsisë kryesisht në vendet që po përballen me ekonominë në tranzicion, prodhimi i ushqimit është e nevojshme të rritet duke llogaritur prej 70 %, ose me fjalë të tjera, me një normë të rritjes vjetore mesatare prej 1.4% gjatë viteve 2011-2050. Këta numra tregojnë se ekziston një nevojë për të dyfishuar prodhimin e tanishëm vjetor të ushqimit në një normë të ngjashme të rritjes që u zbatua në "revolucionin gjelbër", gjatë viteve 60-ta dhe 70-ta. Mungesa e ushqimit mund të çojë në uri të gjerë që mund të krijoj tensione ndërkombëtare. Miliona njerëz ende jetojnë në varfëri dhe vuajnë nga uria, kryesisht në vendet në zhvillim. Pabarazia në të ardhura dhe mungesa e infrastrukturës si dhe mjeteve të komunikimit rrit zbrastirat ekzistuese socio-ekonomike në mes vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.

Erozioni dhe degradimi i cilësisë së tokës, zgjerimi i shkretëtirës, rënia e burimeve ujore dhe cilësia e ujit, përdorimi i pakontrolluar i plehrave dhe kimikateve dhe rritja e migrimit nga zonat rurale drejt zonave urbane, do të kufizojë aftësitë për të prodhuar më shumë ushqim në botë. Ndryshimet e klimës mund të shkaktojnë vështirësi në rritjen e prodhimit të ushqimit, si rezultat i ndryshimeve të temperaturës dhe mund të shkaktojnë fatkeqësi natyrore. Përveç kësaj, përpjekjet e bëra për të zgjeruar tokat e punëshme bujqësore i zvogëlojnë sipërfaqet e zonave pyjore dhe kontibojnë në rritjen e ndryshimeve klimatike, pastaj modifikimet me metodat e inxhinierisë gjenetike ndikojnë në ngadalësimin e ritmit të rritjes vjetore të prodhimit të ushqimit. Hartuesit e politikave, biznesit dhe studiuesit, të gjithë kanë përgjegjësi të madhe për qëndrueshmërinë e të gjithë planetit sot edhe për brezat e ardhshëm. Sfidat me e madhe në botë në shekullin të 21-të është që të bëjnë përpjekje për të mësuar mënyren për të prodhuar sa më shumë ushqim me më pak shpenzime. Zhvillimi i qëndrueshëm do të thotë procesi i zhvillimit që merr në konsideratë mbrojtjen e burimeve natyrore, të resurseve ujore, diversitetin biologjik, ekosistemet, bimëve dhe kafshëve.

Përvoja izraelite për zhvillim dhe revitalizim rural

Ministria duhet të përgatisë politika të qëndrueshme të zhvillimit

Sistemet e menaxhimit të integruar efikasiteti ekologjike i tokës, ujit dhe energjisë

Llogaridhënia dhe taksat

Bashkëpunimi ndërkombëtar



Bujqësia e Izraelit është e përbërë nga prodhime të freskëta, të shëndetshme dhe cilësore të ushqimit, në të gjitha stinët e vitit dhe kontribon në sektorin ekonomik gjatë furnizimit me artikuj ushqimor të përpunuar duke përmirësuar shumë ekonominë e vendit, njëherit kontribon në ruajtjen e mjedisit peisazhit dhe vlerave natyrore.

Qëllimet kryesore:

- Rritja dhe zhvillimi i Agro-Ekonomsë dhe mbrojtjes së burimeve natyrore.
- Dhënia e përparësisë më të larta zhvillimit rural në rajonet e largëta
- Mirëqenien njerëzore në sektorin bujqësor
- Promovimi i sigurisë dhe cilësisë së ushqimit
- Promovimi, mbrojtja dhe përdorimi i qendrueshem i zonave natyrore dhe kulturore
- Ujitja me metoda të sofistikuar duke përdorur ujërat e zeza të recikluara
- Parandalimi i degradimit përdorimin e metodave të integruara biologjike
- Parandalimi i emisioneve të CO2 duke përdorur sisteme alternative të energjisë diellore
- Përdorimi i mbetjeve bujqësore për qëllime të përfitimit të energjisë, gazit dhe kompostit
- Miratimi i metodave për përkujdesjen ndaj kafshëve
- Trajnimi dhe mbështetja e famerve të rinjë
- Programet për mbrojtjen e kulturës rurale, trashëgimisë dhe zonave historike

Bujqësia e gjelbër si mjet për rritjen ekonomike dhe eliminimin e varfërisë duhet të njihet dhe si e tillë duhet të jetë prioritet i qeverisë, kështuqë është e nevojshme të bëhen përpjekje në aspektin global, sidomos në vendet në zhvillim, në mënyrë që të forcohet efektiviteti i përgjithshëm i sistemeve bujqësore, rritja e sigurisë së ushqimit, ulja e varfërisë dhe përmirësimi i të ushqyerit, duke krijuar rritjen ekonomike dhe mbrojtjen e mjedisit. Siguria e qendrueshme e ushqimit dhe menaxhimi i burimeve natyrore, duhet të zhvillohet në çdo vend, që të mundësojë ruajtjen e burimeve natyrore, ndërtimin e kapaciteteve të fermerëve dhe akterve tjerë, qasjen në mjetet financiare, legjislacionin, hulumtimin dhe zhvillim, financa publike dhe planifikim. Politikat e përshtatshme për fermerët në shkallë të vogla dhe të mëdha duhet të miratohen. Bujqësia e gjelbër dhe komunitetet rurale janë thelbësore për mirëqenien e shoqërisë dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe burimeve natyrore, për të balancuar ndikimet e mundshme si rezultat i urbanizimit të shpejtë. Praktikant më të mira të menaxhimit duke përfshirë zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive bujqësore në prodhimin e kulturave duhet të inkurajohen, pastaj hulumtimi dhe zgjerimi i industrisë së fermerve si dhe infrastruktura duhet të forcohet. Partneritetet publiko- private janë të rëndësishme për zbatimin e bujqësisë së gjelbër.

Zhvillimi rural dhe bujqësor në Izrael dhe sfidat në ruajtjen e natyrës

Izraeli ka arritur shkallën më të lartë në zhvillimin rural bujqësor, furnizimin me ujë, politikën e energjisë si dhe në praktikant më të mira për të ruajtjen e biodiversitetit. Zhvillimi i qendrueshëm i bujqësisë dhe menaxhimi i mirëfillt i saj ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe social dhe ruajtjen e mjedisit. Nevojat mjedisore dhe sociale janë të ndryshme krahasuar me ato që ishin pesëdhjetë apo njëqind vite më parë. Në korrik 2002 qeveria izraelite vendosi për krijimin e 13 bashkësive të reja. Sot, shumica e këtyre janë refuzuar ose janë të ngrira nga autoritetet e planifikimit. Kjo reflekton një ndryshim rrënjësor në politikën ndaj asaj që njihet si element fizik. Në fillim të viteve 90-ta politikat e përdorimit të tokës së Izraelit u shqyrtuan tërësisht në një projekt të quajtur Izrael 2020, në të cilin të gjithë ekspertët shkencor në vend kanë marrë pjesë. Bazat që e përbëjnë projektin ishin tokat si burim jetësor i Izraelit. Parashikimet tregojnë se nëse Izraeli vazhdon me skenarin "biznesi si zakonisht", zona e ndërtuar në Izrael do të dyfishohet brenda 25 viteve duke lënë shumë pak hapësira të hapura në të ardhmen e afërt, për natyrën. Në vitin 2000 rreth 15% e tokës së vendit u mbulua nga betoni dhe asfalti. Kjo lë një parcelë të vogël të tokës për të mbështetur vendin, kështu administrata e planifikimit përgatit një politikë alternative për të zhvilluar shtetin, i cili u miratua nga qeveria në mes të viteve 1990. Interesi i organizatës për mbrojtjen e natyrës në Izrael - SPNI-ia për mjedisin në këtë politikë qëndron në faktin se ajo do të konsistojë në zonat më të mëdha të hapësirave të hapura natyrore. Disa autoritete përgjegjëse për tokën në Izrael si, Këshillat Rajonale të Planifikimit dhe Ministria e Bujqësisë vazhdojnë të mbështesin promovimin e komuniteteve të reja duke mos mospërfillur politikën e re. Prandaj, organizatat mjedisore si SPNI-ia shpesh janë në konflikt me agjencitë të ndryshme qeveritare për të siguruar që politikat dhe strategjitë të jenë në harmoni me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Organizata joqeveritare SPNI-ia shoqëria për mbrojtjen e natyrës, për 60-të vitet e fundit është e dedikuar për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve dhe vlerave natyrore të mjedisit, pasurive natyrore dhe peisazheve unike në Izrael.



Kjo organizatë me punën e saj përcaktonë se si do të duket vendi i Izraelit në 50 vitet e ardhshme. SPNI-ia punon vazhdimisht me krijuesit e politikave, komunitetet dhe grupet rinore në të gjithë vendin për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme për Izraelin në shekullin 21. Izraeli është i pasur me biodiversitet, ka shumë lloje të bimëve dhe kafshëve si dhe rreth 500 milion lloje të zogjve. Për këto arsye Izraeli është identifikuar si një pikë e nxehtë e biodiversitetit global. Mirëpo nëse dëshirojmë që biodiversiteti i këtij vendi të ruhet për gjeneratat e ardhshme nevojitet që sa më tepër të bëhen investime.

Vizitat në terren

Sistemi i nevojshëm për mbështetjen e bujqësisë

Serat

Serat janë themeluar në vitin 1998, brenda të cilave është i rregulluar sistemi për ujitje, klima dhe paisjet përcjellëse. Sistemi i tyre rezulton me përfitime të larta dhe kultura të cilësi së mirë, duke siguruar prodhimin më të mirë të produkteve organike dhe bio, pa pesticide, sasia e ujit dhe plehut në to është e reduktuar dhe ekspozimi ndaj sëmundjes është i minimizuar. Serat kanë forma të ndryshme, disa kanë formën e tunelit dhe janë ndërtuar në pesë vitet e fundit me qëllim të rritjes së cilësisë dhe prodhimitarisë. Bashkësit bimore që rriten në këto sera mbulojnë frytet si: qersh, kumbulla, lule, domate, spec, bimë barishtore, dekorative, si dhe bimë me kokrra. Sistemi i tunelit mundëson rritjen e mëhershme, për shembull të luleshtrydhja dy deri në tri javë më herët në pranverë, për tu ringjall prap me 50% të mbjelljes prej gushtit deri në nëntor. Në aspektin e cilësisë së prodhimit rezultatet janë të rëndësishme dhe komerciale. Frutat e buta në klasën një kundrejt klasës dy që rriten në këto sera kanë arritur rreth 90:10 në tunele, krahasuar me 75:25 me prodhimin tradicional në natyrë. Në kushtet e shfrytëzimit, të luleshtrydhet dhe boronicat rendimentet kanë qenë vazhdimisht 30% më e lartë në rastet kur mbrohen nën një tunel në krahasim me prodhimin në natyrë. Tunelet kanë treguar edhe përfitime të tjera si: ditë të garantuara të vjeljes, reduktime të sëmundjeve, lagështi dhe mbi të gjitha aftësinë e konsiderueshme për të përmirësuar dhe ofruar programe të marketingut.



➤ Foto e seres në formë të tunelit





Detyrat primare brenda serave janë:

Monitorimi i prodhimit, menaxhimi i shëndetit të bimëve, ruajtja e qendrueshmerisë dhe cilësisë në sistemet e prodhimit, menaxhimi i sistemeve ushqyese, monitorimi i sëmundjeve dhe rekomandimet për të korrigjuar ato, përfshirë pesticidet. Zhvillimi në sera duhet të jetë i koordinuar duke përfshirë zhvillimin dhe vlerësimin e produkteve të reja për përmirësimin e cilësisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve.

➤ Foto e kulturave bujqësore në serë

Komuniteti kibuc - Regjioni i Lakishit

Këshilli rajonal i Lakishit synon të ofruar kushte të mira të jetesës për banorët, duke bërë zgjerimin e vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimin e vendbanimeve të reja me infrastrukturë komplete në pjesën lindore të tij, me qëllim që sa me tepër të rrit numrin e popullsisë në mënyrë që deri në vitin 2020 të arrijë një numër prej 20.000 banorë. Ky këshillë njëherit angazhohet shumë që të bind banorët për të ndërtuar shtëpitë e tyre në territore rurale në afërsi të qyteteve të Kiryat Gat, Bear Sheva dhe Ashkelon.

Këshilli Rajonal Megidon – është një nga këshillat më të vjetra rajonale në Izrael, i cili është themeluar në vitin 1945 dhe gjendet në pjesën veriore të tij, në Plateu Menashe dhe pjesërisht në Luginën e Jezrelit. Zgjidhja më e vjetër në këshillë është Kibuc, e themeluar në vitin 1926, ndërsa zgjidhja më e re është Moshav, e themeluar në vitin 1952. Në kohën e themelimit të tij, këshilli ka përfshirë vetëm 3.000 banorë me pesë vendbanime në zonën rurale me infrastrukturë të kompletuar. Emblema zyrtare e këshillit është projektuar në vitin 1952, ajo përshkruan kodrat e rajonit, imazhin e grurit dhe luanit. Gruri përfaqëson natyrën rurale dhe bujqësore të territorit të këshillit, kurse imazhi i luanit u frymëzua nga një vulë e zbuluar në qytetin e lashtë të Megidon. Një pjesë e madhe e ushqim në Moshav buron nga kultivimi dhe shitja e rrushit. Lakishi është një nga tre komunitetet në Izrael me numrin më të madh të vreshtave.



➤ Foto e vreshtave të rrushit – majtas dhe rrushi duke u tharë – djathtas


Këshilli Rajonal Megidon përbënë rezervatet e natyrës me sipërfaqe prej 84 milionë metra katrorë, duke përfshirë zonat pyjore, burimet e ndryshme të ujit, kodrat dhe vendet arkeologjike. Parku është aktualisht në proces për t'u bërë i njohur nga UNESCO si Rezervat i Biosferës. Në rezervatet e biosferës, natyra nuk është e izoluar nga njeriu, por natyra duhet ruajtur gjatë përdorimit të saj. Rezervatet e biosferës në këtë rajon janë zona të mbrojtura që janë menduar për tu zhvilluar dhe për të kombinuar qasje të ndryshme të një larmi drejt balancimit të marrëdhënieve në mes njeriut dhe natyrës.

Në mënyrë që një zonë të përfshihet në rrjetin botëror të rezervave të biosferës duhet të ketë informacionin e duhur në lidhje me rajonin e planifikuar dhe poashtu duket të merret pëlqimi nga popullsia lokale. Në rrjetin botëror të rezervateve të biosferës janë përfshirë 553 lokacione që ndodhen në 107 vende.



Jerusalemi

Jerusalemi është kryeqytet i Izraelit dhe njëherit qyteti i shenjtë me tre besime fetare: Judaizmit, Krishterimit dhe Islamit dhe është i vendosur në malet e Judesë, midis Detit Mesdhe dhe Detit të Vdekur, me popullësi prej 801.000 banorë, në një sipërfaqe prej 125.1 km². Pjesët e vjetra të qytetit para 4 mijë vjet p.e.s, janë muret që përcaktojnë qytetin e vjetër, që tradicionalisht ka qenë i ndarë, që nga shekulli 19-të e njohur si lagjet: armene, krishterë, çifut, dhe musliman. Mirëpo me vonë, në vitin 1981 qyteti i vjetër u bë një Trashëgimi Botërore në vend dhe është në mesin e tri vendeve të një rëndësie të jashtëzakonshme fetare. Tempulli i Salmonit, Muri Perëndimor, Kisha e varrit të Shenjtë, Kupola e Shkëmbit dhe Xhamia El-Aksa. Tempulli i Salomonit luan rol të rëndësishëm në historinë hebreje dhe është si depo e arkës së besëlidhjes.



➤ Foto e qytetit të Jerusalemi

Bear Sheva

Bear Sheva shtrihet në veri të shkretëtirës Negev, është qyteti i shtatë më i madh në Izrael, me 194,300 banorë, pjesa më e madhe përbëhet nga hebrejt të cilët imigruan nga vendet arabe pas vitit 1948, ky numër është rrit nga viti 1990 prej emigrantët nga Etiopia dhe ish-Bashkimi Sovjetik. Qyteti u themelua nga ana e Izraelit gjatë shekullit të 10-të dhe ka qenë i banuar për mijëra viteve për shkak të pranisë së rezervave të ujit. Lumi kryesor është Nahal, i cili përmytet në dimer, kurse shterron në verë. Ky lumë e ndan pjesën urbane nga pjesa rurale. Në pjesën rurale planifikohen ndërtimet e reja të shtëpive të orientuara në drejtim të parkut. Në hyrje të parkut dhe lumit, do të ndërtohet një pjesë me mbetje historike si dhe katër qendra të reja tregtare që do të përfshijnë një sipërfaqe prej 115,000 m², pastaj pishina, sistemi për të mbledhur ujin e shiut si dhe ndriçimi nga panelet solare mbi pullaze. Pranë parkut parashifet shtigjet e bicikletave me distancë prej 8.000 metra, tregu i mbyllur me 400 hapësira për shitës i rrethura me gjelbrim si dhe stacioni i autobusave për qytetin i cili do të përmbanë dyqane dhe kafene brenda tij. Qyteti është duke kaluar një fazë të ndërtimit, e cila përfshin dy elemente të dizajnit urban të tilla si burimet e ujit, urat, terenet sportive dhe parqe.



➤ Foto e lumit që e ndan zonën rurale nga zona urbane

Në fund të trajnimit nga pjesëmarrësit u bë evaluimi i punës gjatë javëve të trajnimit dhe secili ka marrë një Çertifikatë si dëshmi e vijimit në këtë trajnim.

